



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.164, datë 11.09.2019

PËR

SKUALIFIKIMIN DHE PËRJASHTIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...} NGA PROCEDURA E EMËRIMIT NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 11.09.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjëndjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z.Illir Toska, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës znj. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr.109, datë 09.07.2019, mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 48, pikat 3/c dhe 5, si dhe nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe në nenin 31, pika 1, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe bërjen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për një pozicion të lirë, që plotësojnë kërkesat specifike për ekspertizë të veçantë në fushën e drejtës civile*”.

2. Brenda afatit të përcaktuar dyjavor nga nga dita e publikimit të vendimit si më lart në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. {...} ka aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurimit për pozicionin e lirë të shpalluar përmes vendimit mësipër.

3. Me Vendimin nr.142, datë 26.07.2019, bazuar në nenin 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: “*Fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatët, nga radhët e juristëve të spikatur, për në pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë*” (pika

1). Po me këtë vendim (pika 2, nëndarja 8), pas shortit të hedhur, për procedurën e verifikimit për kandidaten, znj. {...}, është caktuar si relator z.Ilir Toska.

4. Më datë 26.07.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidaten për: - fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidatja u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit tre ditor, kandidatja depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidatja nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Më datë 29.07.2019, pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të paraqitur në rastin e kandidimit, duke vlerësuar se ky dokumentacion ishte i mangët apo jo konform ligjit (origjinal ose i njesuar me origjinalin), relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidaten për plotësimin e dokumentacionit të kandidimit, bazuar në pikën 9, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019.

7. Po më datë 29.07.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, i dërgoi kandidates formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

8. Brenda afatit pesë ditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit.

9. Ndër dokumentet e dorëzuara nga kandidatja ishte dhe Vërtetimi nr. 896 prot., date 17.07.2019, lëshuar nga Akademia e Forcave të Armatosura, sipas të cilit:

“... Znj. {...} ka mbrojtur dezertacionin me temë “{...}”, me udhëheqës {...}. Juria me vendimin nr. {...}, datë {...} e vlerësoi rezultatin {...}.”

Gjithashtu, bazuar në shkresën e Ministrisë së Sportit dhe Rinisë me nr. {...}, datë {...} “Njoftim për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për gradat shkencore “Doktor”, Zonja {...} është regjistruar në regjistrin përkatës në MASR me nr. {...}”.

10. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 06.08.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, relatori i çështjes kërkoi informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figures, për kandidatët e Gjykatës së Lartë, ndër ta edhe për znj. {...}.

11. Po më datë 06.08.2019, në kuadër të verifikimit të kushtit të kandidimit, atij “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me Shkresën nr. 4163 prot., relatori i çështjes kërkoi informacion dhe konfirmim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në lidhje me fitimin e gradës shkencore në drejtësi nga kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, ndër ta edhe për znj. {...}.

12. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me Shkresën nr. {...}prot., datë {...} (protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 4163/1 prot., datë 26.08.2019), Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë informoi dhe konfirmoi, ndër të tjera, se:

“... ”

2. *Grada shkencore “Doktor” fituar nga znj. {...} figuron e regjistruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademik, pranë MASR, me numër rendor: {...}, Akademia e Forcave të Armatosura, Nr. Vendimi: {...}, datë {...}*

“... ”

Të gjitha gradat shkencore të listuara më sipër, përveç gradës shkencore të fituar nga znj. {...} (Siguri dhe Mbrojtje), i përkasin fushës së drejtësisë.

“... ”

13. Pas të dhënave të grumbulluara në lidhje me gradën shkencore të kandidatës, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi vlerësimin se në rastin konkret verifikohej një rrethanë që mund të çonte në përfundimin se kandidatja nuk plotësonte një nga kushtet e emërimit si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, relatori i çështjes vuri në dijeni Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili, mbështetur në shkronjën “a”, pika 12, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, me Vendimin e datës 28.08.2019, vendosi që: “Kandidati znj. {...} të ftohet për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të saj”.

14. Mbi këtë bazë, më datë 28.08.2019, relatori i çështjes, në rrugë elektronike, njoftoi kandidaten për gjetjen e procedurës së verifikimit, pra në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, duke e ftuar për të paraqitur shpjegime për gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të saj.

15. Brenda afatit pesë ditor, me datë 28.08.2019, në rrugë elektronike, kandidatja paraqiti shpjegimet e saj.

16. Pas marrjes së shpjegimeve nga kandidatja, duke vlerësuar të plota procedurën e verifikimit të ndjekur deri në këtë moment dhe, në veçanti, verifikimet në lidhje me kushtin e kandidimit “të mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, mbi konsideratën se në rastin konkret verifikohej një rrethanë që ishte e aftë për të passjell skualifikimin e kandidatës nga procedura e emërimit, relatori i çështjes ia parashtrori rastin Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

17. Në Mbledhjen e datës 09.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plota procedurat dhe verifikimet për këtë kusht kandidimi për znj. {...}, bazuar në pikën 3, të Seksionit C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për skualifikimin e kandidatës për mosplotësimin e këtij kushti kandidimi ose për vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit.

II. GJETJA E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT DHE VLERËSIMI I SAJ

1. Referuar Vërtetimit nr. {...} prot., date {...}, të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Shkresës nr. {...} prot., datë {...}, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, verifikohej fakti se kandidatja, znj. {...}, mban gradë shkencore, por se kjo gradë nuk është në drejtësi.

2. Sipas nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, *“Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. **Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi”***.

3. Sipas nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, *“Një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë mund të përzgjidhen mes juristëve të spikatur, që kanë gradë shkencore në drejtësi, me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës”*.

4. Nisur nga fakti që vërtetohet, si dhe në referim të ligjit të zbatueshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja, znj. {...}, ndonëse zotëron gradë shkencore, nuk plotëson kushtin e kandidimit të përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përderisa grada shkencore që ajo mban nuk është në drejtësi, por në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

5. Po ashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson të të rregullta dhe të plota procedurat e verifikimit të ndjekura deri në këtë moment për znj. {...}, në veçanti verifikimet sa i përket këtij kushti kandidimi.

III. PRETENDIMET E KANDIDATES DHE VLERËSIMI I TYRE

1. Në shpjegimet e saj, kandidatja, znj. {...}, ka parashtruar: *“... Grada Shkencore që une kam është në Fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Por, pavaresisht kësaj, tema të cilën une kam mbrojtur ka lidhje me fushën e drejtësisë "Media, Opinioni publik dhe e drejta e informimit për çështjet e sigurisë kombëtare", gje të cilën i jam referuar dhe nisa procesin e aplikimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë”*.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të pabazuara pretendimet e kandidatës, znj. {...}, se grada shkencore e saj duhet të konsiderohet si gradë shkencore në drejtësi.

2.1 Konkretisht, sikurse rezulton nga dokumentet zyrtare me fuqi të plotë provuese, por edhe nga sa vetë kandidatja pranon në shpjegimet e saj, del se grada shkencore “Doktor” që ajo mban i përket fushës së sigurisë dhe mbrojtjes.

2.2 Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të papranueshëm pretendimin e kandidatës për interpretimin e fushës së gradës shkencore të saj referuar përmbajtjes së disertacionit shkencor mbi të cilin ajo ka arritur të fitojë gradën, pasi përcaktimi i fushës dhe drejtimi i programit të studimit për fitimin e kësaj grade është bërë nga organi kompetent i institucionit të arsimit të lartë, që i ka dhënë gradën kandidatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon të theksojë se, referuar ligjit për arsimin e lartë, institucioni i arsimit të lartë ku kandidatja ka ndjekur studimet e doktoratës dhe ka fituar gradën shkencore, është një institucion i profilizuar, që do të thotë se programet e studimit të ofruara nga ai, përfshirë edhe ato për ciklin e tretë (studimet e doktoratës), janë të profilizuara sipas fushës përkatëse të kompetencës së institucionit (Akademisë së Forcave të Armatosura), pra në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

2.3 Gjithsesi, përtej kësaj, Këshilli i Lartë Gjyqësor konstaton se gjatë procedurës së verifikimit, kandidatja, megjithëse është ftuar për të paraqitur dokumentacion mbështetës, nuk ka depozituar ndonjë akt provues përmes të cilit të vertetonte pretendimin e saj se programi i studimeve të doktoratës i ofruar në rastin e saj nga Akademia e Forcave të Armatosura ka qënë një program studimi në fushën e drejtësisë, i hartuar dhe miratuar nga senati akademik i këtij institucioni të arsimit të lartë, sikurse edhe nga ministria përgjegjëse për arsimin.

IV. KONKLUZIONE

1. Sa më lart, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në konkluzionin se kandidatja, znj. {...}, nuk plotëson kushtin e kandidimit për në Gjykatën e Lartë, atë të “mbajtjes gradë shkencore në drejtësi”, përcaktuar në nenin 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, prandaj Këshilli është përpara rastit për të vendosur skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatës nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë ku ajo ka konkurruar.

2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson po ashtu se në rastin konkret nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit për këtë kandidatë, përse kohë, sipas ligjit, mosplotësimi edhe i një kushti të vetëm kandidimi passjell skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pika 1 dhe 5, të nenit 49 në lidhje me pikat 4, shkronja “c” dhe 6, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “a”, të nenit 86 dhe nenet 97, 98 dhe 100, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “e”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për

procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I

1. Skualifikimin dhe përjashtimin e kandidates znj. {...} nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 109, datë 09.07.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidatja ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR